



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Prishtinë, më 15 maj 2017

Ref. Nr: 102/01 B

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (*Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010*), nenit 8, paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (*Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011*), dt. 22.03.2011, si dhe dispozitave të nenit 15 të Ligjit 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 2, 8 janar 2016*), nxjerr këtë:

V E N D I M

për afatin dhe datën e organizimit të provimit të maturës shtetërore

1. Provimi i maturës shtetërore, në afatin e qershorit do të organizohet si në vijim:
 - 1.1. Pjesa e parë e provimit me datë 14 qershor 2017.
 - 1.2. Pjesa e dytë e provimit me datë 24 qershor 2017.
2. Rezultatet e provimit të maturës shtetërore në afatin e qershorit, shpallen me 30 qershor 2017.
3. Provimi i maturës shtetërore, në afatin e gushtit do të organizohet si në vijim:
 - 3.1. Pjesa e parë e provimit me datë 25 gusht 2017.
 - 3.2. Pjesa e dytë e provimit me datë 2 shtator 2017.
4. Rezultatet e provimit të maturës shtetërore në afatin e gushtit shpallen me 5 shtator 2017.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI

Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Vendimi ju dërgohet:

1. Komisionit Shtetëror të Maturës;
2. Divizionit për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim;
3. Drejtorive Komunale të Arsimit;
4. Shkollave të Mesme të Larta;
5. Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
6. Departamentit për Arsim të Lartë MASHT;
7. Arkivit të MASHT.